



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5143 Prot.

Roskovec, më 21.07 2021

VENDIM

NR. 61 .DATË 21.07.2021

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” Z.JASHAR ÇEPELE

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 54, gërma k, dhe m; Ligjin nr. 112/2013. “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Bashkiak

VENDOSI:

1- Dhënien e Titullit “Qytetar Nderi” i Bashkisë Roskovec për Z. Jashar Çepele me motivacionin:

“Për kontribut të veçantë në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si Kryetar i Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar të fshatit Jagodinë e sipërme dhe kthimin e shtëpisë së tij ne bazë të kësaj lufte”.

2- Ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Shëndetësisë, Projekteve Sociale, Kordinimi me BE-në dhe Shërbimeve Komunitare për zbatimin e këtij vendimi.

3- Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

